FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.77 28 qershor 2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9751 datë 7.6.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar ……	2311
Ligj nr.9752 datë 7.6.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 "Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit", të ndryshuar……	2318
Ligj nr.9754 datë 14.6.2007	Për përgjegjësinë penale të personave juridikë ……	2319
Ligj nr.9755 datë 14.6.2007	Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar…	2326

LIGJ
Nr.9751, datë 7.6.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7638, DATË 19.11.1992 "PËR SHOQËRITË TREGTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 40

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar duhet të nënshkruhen, në tërësinë e tyre, nga ortakët, si për rastet kur përfaqësojnë kontribute në natyrë, ashtu edhe për kontributet në para. Ato nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime. Pjesëmarrja në kapitalin themeltar shënohet në statut.".

Neni 2

Pas nenit 78 shtohet neni 78/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 78/1
Njoftimi gjatë themelimit të një shoqërie anonime me oferta publike

Njoftimi i parashikuar në pikën 2 të nenit 78 të këtij ligji botohet në një gazetë të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore, përpara fillimit të veprimtarive për nënshkrim dhe përpara çdo veprimi tjetër publikimi.

Ky njoftim tregon emërtimin e shoqërisë, shumën e kapitalit themeltar që duhet nënshkruar, adresën e parashikuar të selisë së shoqërisë, një përmbledhje të objektit të shoqërisë, kohëzgjatjen e shoqërisë, kur ajo është e përcaktuar, datën dhe vendin e depozitimit të projektstatutit, si dhe:

a) numrin e aksioneve për kontributin në para, që janë për t'u nënshkruar dhe shumën që kërkohet menjëherë;

b) vlerën nominale të aksioneve, që janë për t'u emetuar;

c) përshkrimin e përmbledhur të kontributeve në natyrë, vlerësimin global të tyre dhe mënyrën e shlyerjes;

ç) përparësitë e veçanta, të formuluara në projektstatut, të cilat i përfiton çdo person;

d) kushtet e pranimit dhe të ushtrimit të së drejtës së votës në mbledhjet e asamblesë së aksionerëve;

dh) në qoftë se është e nevojshme, klauzolat përkatëse për miratimin e personave që i shesin aksionet e tyre;

e) dispozitat përkatëse për shpërndarjen e fitimeve, krijimin e rezervave dhe shpërndarjen e shumës, që mbetet pas likuidimit të shoqërisë;

ë) emrin dhe adresën e noterit ose emërtimin dhe selinë e bankës, ku do të depozitohen fondet e ardhura nga nënshkrimi;

f) afatin e caktuar për nënshkrim, duke lënë të hapur mundësinë e mbylljes së parakohshme të

nënshkrimit, nëse nënshkrimi është bërë i plotë, përpara përfundimit të afatit të mësipërm;

g) mënyrën e thirrjes së asamblesë themeluese dhe vendin e mbledhjes.

Njoftimi nënshkruhet nga themeluesit e shoqërisë, të cilët shënojnë emrat, mbiemrat, adresat e banimit dhe shtëpinë ose emërtimin, formën, selinë dhe shumën e kapitalit themelor të shoqërisë së tyre.".

Neni 3

Pas nenit 80 shtohet neni 80/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 80/1
Prospektet dhe qarkoret

Prospektet, për qëllim reklame dhe qarkoret, që informojnë botimin për emetimin e aksioneve, përmbajnë të njëjtat njoftime si ato të parashikuara në nenin 78/1, si dhe shënimin se njoftimi është botuar në një gazetë të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore, duke dhënë referencën për emrin e gazetës dhe numrin ku është botuar njoftimi.

Gjithashtu, ato duhet të paraqesin, në mënyrë të përmbledhur, projektet e themeluesve për sa i përket përdorimit të fondeve, që vijnë nga shlyerja e aksioneve të nënshkruara.".

Neni 4

Pas nenit 81 shtohet neni 81/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 81/1
Të dhënat e buletinit të nënshkrimeve

Buletini i nënshkrimeve, i parashikuar në nenin 81 të këtij ligji, përmban datën dhe firmën e nënshkruesit ose të personit të autorizuar prej tij me prokurë, i cili shkruan edhe me shkronja numrin e aksioneve që ai nënshkruan. Atij i jepet një kopje e buletinit.

Në buletinin e nënshkrimeve përcaktohen emri i shoqërisë, shuma e kapitalit themeltar për t'u nënshkruar, adresa e parashikuar e selisë së shoqërisë, një përmbledhje e objektit të shoqërisë, data dhe vendi i depozitimit të projektstatutit, si dhe:

a) nëse është e nevojshme, pjesa e kapitalit në para, që duhet nënshkruar dhe pjesa e kapitalit, që vjen nga kontributet në natyrë;

b) mënyra e emetimit të aksioneve, të nënshkruara për kontributin në para;

c) emri dhe adresa e noterit ose emri dhe selia e bankës, ku do të depozitohen fondet e ardhura nga nënshkrimi;

ç) emri, mbiemri dhe adresa e banimit të nënshkruesit, si dhe numri i letrave me vlerë, të nënshkruara prej tij;

d) shënimin për dhënien nënshkruesit të një kopjeje të buletinit të nënshkrimeve;

dh) data e botimit të njoftimit, të parashikuar në nenin 78/1 të këtij ligji, në një gazetë të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore.".

Neni 5

Pas nenit 146 shtohen nenet 146/1, 146/2, 146/3 dhe 146/4 me këtë përmbajtje:

"Neni 146/1
Drejtimi i mbledhjes së asamblesë

Mbledhjet e asamblesë së aksionerëve drejtohen nga kryetari i këshillit mbikëqyrës ose, në mungesë të tij, nga personi i parashikuar në statut, përndryshe vetë asambleja zgjedh një drejtues të mbledhjes së saj. Në rast thirrjeje të asamblesë nga ekspertët kontabël të autorizuar, nga një mandatmbajtës i autorizuar nga gjykata ose nga likuiduesit, mbledhja e asamblesë drejtohet nga

personi ose njëri prej personave, që e kanë thirrur këtë mbledhje. Drejtuesi i asamblesë cakton një sekretar që, me përjashtim të rasteve kur në statut ka dispozita të kundërta, mund të mos jetë aksioner.

Neni 146/2
Evidenca e pjesëmarrjes

Evidenca e pjesëmarrjes së aksionerëve në mbledhjen e asamblesë, e parashikuar në nenin 142 të këtij ligji, përmban:

a) emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo aksioneri të pranishëm, numrin e aksioneve që ai zotëron, si dhe numrin e votave që u përgjigjet këtyre aksioneve;

b) emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo aksioneri të përfaqësuar, numrin e aksioneve që ai zotëron dhe numrin e votave që u përgjigjet këtyre aksioneve;

c) emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo mandatmbajtësi, numrin e aksioneve të personave, që ia kanë dhënë atij këtë mandat, si dhe numrin e votave që u përgjigjet këtyre aksioneve;

ç) emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo aksioneri, që i ka çuar me korrespondencë shoqërisë një formular vote, si dhe numrin e aksioneve që ai zotëron e numrin e votave që u përgjigjet këtyre aksioneve.

Evidenca e pjesëmarrjes, e nënshkruar sipas rregullave nga aksionerët e pranishëm dhe mandatmbajtës, vërtetohet nga drejtuesi dhe sekretari i asamblesë.

Neni 146/3
Procesverbali

Në procesverbalin e çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë përcaktohen data dhe vendi i mbledhjes, mënyra e thirrjes, rendi i ditës, emri i drejtuesit dhe i sekretarit të asamblesë, numri i aksioneve, me të cilat është votuar dhe kuorumi i arritur, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë, një përmbledhje e debateve, teksti i vendimeve të kaluara në votim dhe rezultati i votimit.

Procesverbali nënshkruhet nga drejtuesi dhe sekretari i asamblesë.

Neni 146/4
Ruajtja e evidencave të pjesëmarrjes dhe e procesverbaleve

Evidencat e pjesëmarrjes dhe procesverbalet ruhen në selinë e shoqërisë.”.

Neni 6

Pas nenit 151 shtohet neni 151/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 151/1
Shpallja e emetimit

Aksionerët vihen në dijeni për emetimin e aksioneve të reja dhe për mënyrën e emetimit nëpërmjet një shpalljeje, ku përcaktohen emetimi i shoqërisë, shuma e kapitalit themeltar, adresa e selisë së shoqërisë, numri i regjistrimit në regjistrin tregtar dhe:

a) shuma e zmadhimit të kapitalit;

b) datat e hapjes dhe të mbylljes së nënshkrimeve;

c) qenien në dobi të aksionerëve të së drejtës së përparësisë në nënshkrimin e aksioneve të reja, si dhe kushtet e ushtrimit të kësaj të drejte;

ç) vlera nominale e aksioneve për kontributin në para që duhet nënshkruar dhe, në qoftë se është e nevojshme, shuma e primit të emetimit;

d) shuma që kërkohet të paguhet menjëherë nga aksionet e nënshkruara;

dh) emri i personit fizik ose emri i shoqërisë, adresa e banimit ose e selisë së depozituesit;

e) nëse është e nevojshme, përshkrimi i përmbledhur, vlerësimi dhe mënyra e shlyerjes së kontributeve në natyrë, që përmbahen në zmadhimin e kapitalit, duke treguar karakterin e përkohshëm

të këtij vlerësimi dhe të kësaj mënyre shlyerjeje;

ë) shënimi se, nëse aksionet e përshkruara përfaqësojnë më shumë se tre për qind të zmadhimit të kapitalit, nënshkrimi do të jetë i hapur për publikun e gjerë ose do të quhet i mbyllur me shumën e nënshkrimeve të kryera.

Nëse shoqëria është me ofertë publike, shpallja futet në një njoftim të botuar në një gazetë të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore. Ky botim duhet të bëhet i njohur për publikun të paktën 6 ditë përpara datës së hapjes së nënshkrimit.

Në rast të kundërt, njoftimet e parashikuara në paragrafin e mësipërm, brenda të njëjtit afat, u bëhen të njohura aksionerëve me letër rekomande me përgjigje për marrjen e lajmërimit.".

Neni 7

Pas nenit 152 shtohen nenet 152/1, 152/2, 152/3 dhe 152/4 me këtë përmbajtje:

"Neni 152/1
Përjashtimi, në rast se hiqet dorë nga e drejta e përparësisë

Në qoftë se asambleja ka vendosur për të hequr dorë nga e drejta e përparësisë së aksionerëve në nënshkrim, dispozitat e nenit 151/1 të këtij ligji nuk zbatohen.".

Neni 152/2
Përmbajtja e njoftimit për publikun

Njoftimi, i përmendur në paragrafin e dytë të nenit 151/1 të këtij ligji, përmban këto të dhëna:

a) përmbledhjen e objektit të shoqërisë;

b) datën e përfundimit normal të shoqërisë, kur kohëzgjatja e saj është përcaktuar;

c) kategoritë e aksioneve të emetuara dhe karakteristikat e tyre;

ç) përparësitë e veçanta, të formuluara në statut, në dobi të çdo personi;

d) kushtet e pranimit dhe të ushtrimit të së drejtës së votës në asambletë e aksionerëve;

dh) në qoftë se është e nevojshme, klauzolat e statutit, që kufizojnë shitjen e lirë të aksioneve;

e) dispozitat përkatëse për shpërndarjen e fitimeve, krijimin e rezervave dhe shpërndarjen e shumës, që mbetet pas likuidimit të shoqërisë;

ë) në qoftë se është e nevojshme, shumën e obligacioneve të konvertueshme në aksione, të emetuara më parë, afatet e ushtrimit të mundësisë, që u është dhënë prurësve ose shënimin se konvertimi mund të bëhet në çdo kohë, si dhe bazat e konvertimit;

f) shumën e paamortizuar të obligacioneve të tjera, që janë emetuar më parë dhe garancitë, me të cilat ato janë shoqëruar;

g) shumën e huave të garantuara nga shoqëria dhe, në qoftë se është e nevojshme, pjesën e garantuar të këtyre huave gjatë procesit të emetimit.

Njoftimi përmban nënshkrimin dhe vulën e shoqërisë.

Neni 152/3
Bilanci që duhet t'i bashkëngjitet njoftimit

Një kopje e bilancit të fundit, e vërtetuar, sipas rregullave, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, botohet si aneks i njoftimit që parashikon neni 152/2. Në qoftë se bilanci i fundit është botuar sipas rregullave të parashikuara me ligjin e veçantë për botimet e regjistrit tregtar dhe të legjislacionit në fuqi, për tregtimin e letrave me vlerë, kopja e këtij bilanci mund të zëvendësohet me një shënim, ku jepet referenca e botimit të mëparshëm.

Neni 152/4
Prospektet dhe qarkoret

Prospektet, për qëllime reklame dhe qarkoret, që informojnë publikun për emetimin e aksioneve, përmbajnë të njëjtat njoftime si ato të parashikuara në nenin 152/2 të këtij ligji, si dhe

shënimin se njoftimi është botuar në një gazetë zyrtare të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore, duke dhënë referencën për emrin e gazetës dhe numrin e saj, ku është botuar njoftimi.”.

Neni 8

Pas nenit 159 shtohet neni 159/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 159/1
Të dhënat e buletinit të nënshkrimeve

Në buletinin e nënshkrimeve, të parashikuara në nenin 159 të këtij ligji, shënohet data dhe nënshkrimi i nënshkruesit ose mandatmbajtësit, që shkruan edhe me shkronja numrin aksioneve të nënshkruara prej tyre. Atij i jepet një kopje e buletinit.

Buletini i nënshkrimeve përmban emrin e shoqërisë, shumën e kapitalit themeltar, adresën e selisë së shoqërisë, numrin e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe:

a) shumën dhe mënyrat e zmadhimit të kapitalit;

b) në qoftë se është e nevojshme, shumën për t’u nënshkruar të aksioneve për kontributet në para dhe shumën e shlyer për kontributet në natyrë;

c) emrin dhe adresën e noterit ose emrin dhe selinë e bankës, ku do të depozitohen fondet e ardhura nga nënshkrimi;

ç) emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të nënshkruesit, si dhe numrin e letrave me vlerë të nënshkruara prej tij;

d) njoftimin se nënshkruesit i është dhënë një kopje e buletinit të nënshkrimeve.”.

Neni 9

Në nenin 187 paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Vendimi për shndërrim botohet sipas legjislacionit që rregullon botimet e shoqërive tregtare.”.

Neni 10

Në nenin 190 paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Në të dyja rastet zgjidhja e dhënë nga asambleja e përgjithshme botohet sipas legjislacionit që rregullon botimet e shoqërive tregtare.”.

Neni 11

Pas nenit 244 shtohet neni 244/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 244/1
Projekti i bashkimit ose i ndarjes

Projekti i bashkimit ose i ndarjes formulohet nga drejtoria, administratori ose administratorët e secilës prej shoqërive, që marrin pjesë në operacionin e bashkimit ose të ndarjes së projektuar. Ai duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) formën, emrin dhe selinë e të gjitha shoqërive pjesëmarrëse;

b) motivet, qëllimet dhe kushtet e bashkimit ose të ndarjes;

c) caktimin dhe vlerësimin e aktivit dhe të pasivit, që janë parashikuar t’u kalojnë shoqërive përthithëse ose të reja;

ç) mënyrat e dorëzimit të pjesëve të kapitalit themeltar ose aksioneve dhe datën, pas së cilës këto pjesë ose aksione japin të drejtën për pjesëmarrje në fitime, si dhe çdo modalitet të veçantë, që lidhet me këtë të drejtë. Gjithashtu, projekti duhet të përmbajë datën, pas së cilës operacionet e shoqërisë së përthithur ose të ndarë vlerësohen, në aspektin e kontabilitetit, si të kryera nga shoqëria ose shoqëritë që përfitojnë kontributet;

d) datat, në të cilat janë hartuar llogaritë e shoqërive të interesuara, që përdoren për të

formuluar kushtet e operacionit;

dh) raportin e këmbimit të të drejtave në shoqëri dhe, në qoftë se është e nevojshme, shumën që duhet paguar për të kompensuar pabarazinë e këtyre të drejtave të këmbyera;

e) shumën e parashikuar të primit të bashkimit ose të ndarjes;

ë) të drejtat e dhëna ortakëve, që kanë të drejta të veçanta dhe prurësve të letrave me vlerë, të ndryshme nga aksionet, si dhe, në qoftë se është e nevojshme, të gjitha përparësitë e veçanta.".

Neni 12

Në nenin 248 fjalia e fundit e paragrafit të tretë shfuqizohet.

Neni 13

Pas nenit 248 shtohen nenet 248/1 e 248/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 248/1
Shpallja e projektit të bashkimit ose të ndarjes

Projekti i bashkimit ose i ndarjes botohet edhe në formën e një shpalljeje në një gazetë, të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore, nga secila prej shoqërive që marrin pjesë në operacion.

Kjo shpallje përmban të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e shoqërisë, adresën e selisë, shumën e kapitalit dhe numrat e regjistrimit në regjistrin tregtar të secilës prej shoqërive që marrin pjesë në operacion;

b) emrin e shoqërisë, adresën e selisë dhe shumën e kapitalit të shoqërive të reja, që do të dalin nga operacioni, ose shumën e zmadhimit të kapitalit të shoqërive ekzistuese;

c) vlerësimin e aktivit dhe të pasivit, të cilët janë parashikuar t'u kalojnë shoqërive përthithëse ose të reja;

ç) raportin e këmbimit të të drejtave në shoqëri;

d) shumën e parashikuar të primit të bashkimit ose të ndarjes;

dh) datën e projektit, si dhe datën e vendin e depozitimeve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 248 të këtij ligji dhe botimi, i parashikuar në shkronjat e përmendura më lart, duhet të bëhet të paktën një muaj përpara datës së mbledhjes së parë të asamblesë, të thirrur për të marrë vendim për operacionin.

Neni 248/2
Deklaratë në përputhje me rregullat

Deklarata e parashikuar në paragrafin e tretë të nenit 248 të këtij ligji depozitohet në regjistrin tregtar.

Ajo duhet të nënshkruhet të paktën nga një anëtar i drejtorisë ose nga administratori i secilës prej shoqërive pjesëmarrëse, që kanë një mandat për këtë qëllim.

Një kopje depozitohet në regjistrin tregtar, për çdo shoqëri pjesëmarrëse.".

Neni 14

Në nenin 255 fjalia e parë e paragrafit të dytë ndryshohet si më poshtë:

"Kreditorët e shoqërive, që marrin pjesë në operacionin e bashkimit dhe që kanë dhënë kredi para botimit të projektbashkimit, mund ta kundërshtojnë bashkimin, brenda një afati prej 30 ditësh, duke filluar nga data e botimit të regjistrimit në regjistrin tregtar apo në gazetën e autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore, cilado qoftë data e mëvonshme.".

Neni 15

Pas nenit 265 shtohet neni 265/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 265/1
Emërimi i likuiduesve

Emërimi dhe të dhënat e likuiduesve duhet të regjistrohen në regjistrin tregtar, së bashku me aktin e emërimit.".

Neni 16

Pas nenit 279 shtohet neni 279/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 279/1
Shpallja e mbylljes së likuidimit

Shpallja e mbylljes së likuidimit, e nënshkruar nga likuiduesi dhe nën kujdesin e tij, botohet në një gazetë, të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore dhe regjistrohet në regjistrin tregtar.

Në shpallje jepen emri i shoqërisë, shuma e kapitalit themeltar, adresa e selisë së shoqërisë, numri i regjistrimit në regjistrin tregtar, si dhe:

a) emrat, mbiemrat dhe adresat e banimit të likuiduesve;

b) data dhe vendi i mbledhjes së asamblesë për mbylljen, në qoftë se llogaritë e likuiduesve janë miratuar prej saj ose, në rast të kundërt, data e vendimit gjyqësor, të parashikuar në nenin 271 të ligjit, si dhe gjykata që e ka marrë këtë vendim.".

Neni 17

Pas nenit 302 shtohet neni 302/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 302/1
Caktimi i gazetave të autorizuara për botimin e njoftimeve ligjore

Gazetat e autorizuara për botimin e njoftimeve ligjore caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5369, datë 25.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9752, datë 7.6.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8932, DATË 26.7.2002 "PËR DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË AFGANISTAN, NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 83 pika 1 dhe 84 pika 4 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 "Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizimit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 fjalët "një nënrepart i brigadës së reagimit të shpejtë, së bashku me elementet mbështetëse" zëvendësohen me fjalët "një kompani e Forcave të Armatosura, së bashku me elementet mbështetëse".

Neni 2

Në nenin 2 fjalët "të nënrepartit" zëvendësohen me fjalët "të kompanisë".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5370, datë 25.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9754, datë 14.6.2007

PËR PËRGJEGJËSINË PENALE TË PERSONAVE JURIDIKË

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat për përgjegjësinë, procedimin penal dhe llojet e masave ndëshkuese, që merren ndaj personave juridikë, për kryerjen e veprës penale.

Neni 2
Zbatimi i ligjit penal

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj personave juridikë për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në Kodin Penal, në Kodin e Procedurës Penale dhe në dispozita të tjera penale. Në rast se nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj, ndaj personave juridikë zbatohen, gjithashtu, dispozitat e legjislacionit civilo-tregtar.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj personave juridikë të huaj, që kanë fituar personalitet juridik, sipas legjislacionit shqiptar.
3. Ky ligj nuk pengon vendosjen dhe ekzekutimin e masave të ndëshkimeve administrative nga organet tatimore dhe organet e tjera të administratës publike, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU II
BAZAT E PËRGJEGJËSISË SË PERSONAVE JURIDIKË QË KRYEJNË VEPRA PENALE

Neni 3
Përgjegjësia e personit juridik për kryerjen e veprës penale

Personi juridik ka përgjegjësi për vepra penale të kryera:

a) në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij;

b) në emër ose në dobi të tij, nga një person, që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik;

c) në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik.

Neni 4
Organe dhe përfaqësues që veprojnë në emër ose në dobi të personit juridik

Në kuptim të nenit 3 shkronja "a" të këtij ligji, organ dhe përfaqësues i personit juridik, që vepron në emër ose në dobi të personit juridik, është çdo person fizik, i cili, sipas ligjit ose akteve të personit juridik, është ngarkuar për përfaqësimin, drejtimin, administrimin ose kontrollin e fushës së veprimtarisë së personit juridik dhe të strukturave të tij.

Neni 5
Shndërrimi i personit juridik

Në rastin e ndryshimit të statusit ligjor, formës ose shndërrimit të personit juridik, në çdo fazë të procedimit penal, hetimet zhvillohen dhe dënimet jepen ndaj personit të ri juridik edhe për veprat penale të kryera përpara datës së shndërrimit.

Neni 6
Bashkimi i personave juridikë

Në rastin e bashkimit të personave juridikë edhe nëpërmjet përthithjes, përpara dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit nga gjykata, hetimet zhvillohen dhe dënimet jepen ndaj personit të ri juridik edhe për vepra penale të kryera përpara datës së bashkimit të tyre.

Neni 7
Ndarja e personit juridik

Në rastin e ndarjes së personit juridik përpara dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit nga gjykata, hetimet zhvillohen dhe dënimet jepen ndaj personave juridikë, që krijohen nga ndarja, edhe për vepra penale të kryera përpara datës së ndarjes së tij.

KREU III
MASAT NDËSHKUESE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË

Neni 8
Llojet e masave ndëshkuese ndaj personave juridikë

Ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, jepen këto masa ndëshkuese:

a) dënime kryesore;

b) dënime plotësuese.

Neni 9
Dënimet kryesore

1. Ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, jepen këto dënime kryesore:

a) gjobë;

b) mbarim i personit juridik.

2. Dënimi kryesor, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet për njësitë e qeverisjes vendore, për personat juridikë publikë dhe për partitë politike e sindikatat.

Neni 10
Dënimet plotësuese

1. Ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, bashkë me dënimin kryesor mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese:

a) mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik;

b) vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar;

c) ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike;

ç) heqja e së drejtës së marrjes ose përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve ose subvencioneve;

d) ndalimi për të kërkuar publikisht fonde dhe burime financiare;

dh) heqja e së drejtës së ushtrimit të një apo më shumë veprimtarive ose operacioneve;

e) detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.

2. Dënimet plotësuese, të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d" dhe "dh" të pikës 1 të këtij neni, nuk zbatohen për njësitë e qeverisjes vendore, personat juridikë publikë, partitë politike dhe sindikatat.

3. Dënimet plotësuese ekzekutohen së bashku me dënimin kryesor.

4. Gjykata, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 36 të Kodit Penal, vendos, në çdo rast, konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe të produkteve të veprës penale.

Neni 11
Dënimi me gjobë

1. Dënimi me gjobë, në kuptim të nenit 9 të këtij ligji, konsiston në pagimin, në favor të shtetit, të një shume të hollash, brenda kufijve të parashikuar në këtë ligj.

2. Shlyerja e dënimit me gjobë bëhet nga pasuritë e personit juridik të dënuar, sipas mënyrës dhe afateve që caktohen nga gjykata.

3. Në rast pamundësie apo pengese në shlyerjen e dënimit me gjobë, gjykata, me kërkesë të prokurorit, vendos ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të dënimit. Nëse personi juridik nuk disponon fonde dhe pasuri për shlyerjen e dënimit me gjobë, gjykata mund ta zëvendësojë atë me dënimin kryesor, mbarimin e personit juridik.

4. Në varësi të llojit të veprës penale zbatohen dënimet me gjobë, si më poshtë:

a) për krimet që, sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, minimumi, jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet burgim ose burgim i përjetshëm, personi juridik dënohet me gjobë nga 25 milionë lekë deri në 50 milionë lekë;

b) për krime që, sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, minimumi, jo më pak se shtatë vjet deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim, personi juridik dënohet me gjobë nga 5 milionë lekë deri në 25 milionë lekë;

c) për krime që, sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, maksimumi, më pak se shtatë vjet, personi juridik dënohet me gjobë nga 500 mijë lekë deri në 5 milionë lekë.

5. Në rastin e përgjegjësisë së personit juridik për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, personi juridik dënohet me gjobë nga 300 mijë lekë deri në 1 milion lekë.

Neni 12
Mbarimi i personit juridik

1. Mbarimi i personit juridik, për shkak të përgjegjësisë për kryerjen e veprës penale, jepet kur ekziston njëra nga shkaqet e mëposhtme:

a) është themeluar me qëllim kryerjen e veprës penale;

b) ka përdorur në një masë të rëndësishme fushën e veprimtarisë së tij për t'i shërbyer kryerjes së veprës penale;

c) kanë ardhur pasoja të rënda nga kryerja e veprës penale.

2. Mbarimi i personit juridik, për shkak të përgjegjësisë për kryerjen e veprës penale, mund të jepet edhe në rastet e kryerjes së veprës penale më shumë se një herë dhe për rrethana të tjera rënduese, sipas Kodit Penal dhe dispozitave të tjera penale.

3. Vendimi për mbarimin e personit juridik realizohet nëpërmjet procedurave për likuidimin e detyruar të tij nga organet kompetente, sipas ligjit. Pjesa e të ardhurave dhe e pasurive që, në përfundim të procedurës së likuidimit të detyruar të personit juridik, rezultojnë të jenë mjete apo produkte të veprës penale konfiskohen.

Neni 13

Mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik

1. Mbyllja përgjithmonë e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik jepet, kur ato janë përdorur në kryerjen e një krimi, që ka sjellë pasoja të rënda dhe çmohet se mbajtja e tyre nuk pajtohet me natyrën e veprës penale të kryer.

2. Mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik mund të jepet për një kohë nga një deri në pesë vjet.

Neni 14

Vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar

1. Vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar jepet për një kohë nga një deri në pesë vjet, kur çmohet se një masë e tillë ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar mund të jepet nëse:

a) personi juridik ofron shërbime dhe kryen veprimtari në interes publik;

b) për shkak të rrethanave ekonomike dhe shoqërore, që lidhen me llojin, përmasat dhe vendin ku zhvillohet veprimtaria e personit juridik, çmohet se zbatimi i dënimeve të parashikuara në nenet 12 e 13 të këtij ligji sjell pasoja të rënda në punësim, në zhvillimin ekonomik e shoqëror dhe në mbrojtjen e mjedisit.

3. Me vendosjen e personit juridik në administrim të kontrolluar, gjykata përcakton administratorin apo administratorët, detyrat dhe kompetencat e të cilëve lidhen vetëm me ato fusha të veprimtarisë, që janë themeluar ose përdorur për kryerjen e veprave penale.

4. Brenda kompetencave të përcaktuara nga gjykata, administratori kujdeset edhe për zbatimin dhe përmbushjen me sukses të modeleve të organizimit dhe kontrollit efektiv për parandalimin e veprës penale.

5. Administratorët, të paktën një herë në katër muaj, i paraqesin gjykatës një informacion të hollësishëm, me shkrim, për mënyrën e përmbushjes së detyrave dhe të kompetencave të tyre. Një kopje e informacionit i dërgohet edhe prokurorit.

6. Gjykata, me kërkesën e personave të interesuar apo të prokurorit, pas shqyrtimit të informacionit dhe shpjegimeve të administratorit, mund të vendosë heqjen e masës së administrimit të kontrolluar ose zëvendësimin e tij me një dënim të ri, kryesor ose plotësues.

Neni 15

Ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike

1. Ndalimi për të përfituar ose për të marrë pjesë drejtpërdrejt ose jo në transaksione dhe shpërndarje të fondeve publike, në marrëdhënie kontraktore dhe procedura të prokurimit të fondeve

publike me institucione shtetërore, qendrore apo vendore, persona të tjerë juridikë publikë ose të kontrolluar nga ata, jepet për një kohë nga një deri në pesë vjet, kur çmohet se ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Në rastin e përgjegjësisë për kryerjen e një krimi të parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 4 të nenit 11 të këtij ligji, dënimi jepet për një afat jo më pak se katër vjet dhe, kur kanë ardhur pasoja të rënda, gjykata mund të vendosë ndalimin e përhershëm.

Neni 16

Heqja e së drejtës së marrjes ose e përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve ose subvencioneve

1. Heqja e së drejtës së marrjes ose e përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve dhe subvencioneve nga institucione shtetërore, qendrore apo vendore, persona të tjerë juridikë publikë ose të kontrolluar nga ata, jepet për një kohë nga një deri në pesë vjet, kur çmohet se ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Në rastin e përgjegjësisë për kryerjen e një krimi të parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 4 të nenit 11 të këtij ligji, dënimi jepet për një afat jo më pak se tre vjet dhe, kur kanë ardhur pasoja të rënda, gjykata mund të vendosë që kjo e drejtë të mos ushtrohet përgjithmonë.

Neni 17

Ndalimi për të kërkuar publikisht fonde dhe për të reklamuar veprimtarinë

1. Ndalimi i personit juridik për të kërkuar publikisht fonde, burime financiare dhe garanci, për t'iu drejtuar për këtë qëllim bankave, institucioneve financiare dhe tregut të kapitaleve, ose për të reklamuar veprimtaritë e tij, jepet nga gjykata për një kohë nga një deri në tre vjet, kur çmohet se ka efekt parandalues ose pajtohet me natyrën e veprës së kryer.

2. Në rastin e përgjegjësisë për kryerjen e një krimi të parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 4 të nenit 11 të këtij ligji, dënimi jepet për një afat jo më pak se dy vjet.

Neni 18

Ndalimi i ushtrimit të një apo më shumë veprimtarive

1. Ndalimi i ushtrimit drejtpërdrejt ose jo të një ose më shumë veprimtarive jepet nga gjykata për një kohë nga një deri në katër vjet, kur gjatë ushtrimit apo për shkak të këtyre veprimtarive është kryer vepra penale, ose kur çmohet se personi juridik i ka shpërdoruar ato.

2. Në rastin e përgjegjësisë për kryerjen e një krimi të parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 4 të nenit 11 të këtij ligji, dënimi jepet për një afat jo më pak se tre vjet.

Neni 19

Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor

1. Publikimi i vendimit gjyqësor ose i njoftimit rreth përmbajtjes së tij, nëpërmjet shtypit të shkruar, llojeve të tjera të organeve të informimit publik, shpalljeve në vende të caktuara dhe mënyrave të tjera të informimit urdhërohet nga gjykata, kur çmohet se njohja e tij publikisht ka interes për personat fizikë dhe juridikë.

2. Publikimi i pjesshëm ose tërësor i vendimit gjyqësor, mënyrat, organet e shtypit, ditët dhe kohëzgjatja e publikimit caktohen nga gjykata. Shpenzimet e publikimit të vendimit gjyqësor janë në ngarkim të personit juridik të dënuar.

3. Organet e shtypit dhe të radiotelevizionit janë të detyruara të bëjnë publikimin e vendimit gjyqësor të dërguar nga gjykata.

4. Publikimi i vendimit gjyqësor nuk bëhet kur cenohet jeta private e viktimave të veprës penale dhe e personave të tjerë, përveç rasteve kur ata japin pëlqimin, kur preket morali shoqëror ose kur rrezikohet përhapja e sekretit shtetëror.

KREU IV
RREGULLA PËR CAKTIMIN E DËNIMIT DHE REHABILITIMI

Neni 20
Rrethana lehtësuese për personat juridikë

Përveç sa parashikohet në kreun VI pjesa e përgjithshme e Kodit Penal, dënimi i personave juridikë lehtësohet kur:

a) personi juridik ka shlyer plotësisht dëmin dhe ka eliminuar pasojat e dëmshme ose të rrezikshme të veprës penale;

b) personi juridik ka eliminuar mangësitë organizative, që kanë sjellë si pasojë veprën penale, nëpërmjet zbatimit të modeleve organizative, të përshtatshme për parandalimin e veprës penale;

c) personi juridik ka vënë në dispozicion të ardhurat për qëllime konfiskimi.

Neni 21
Kryerja më shumë se një herë e veprës penale

Në rastin kur gjykata vendos për përgjegjësinë e personit juridik për kryerjen e një vepre të re penale brenda pesë vjetëve nga data e kryerjes së veprës së mëparshme penale, masa e gjobës dhe koha e vuajtjes së dënimeve plotësuese, që caktohen për veprën e re penale, shtohen dy deri në tre herë, në varësi të faktit nëse veprat penale të kryera janë kundërvajtje penale ose krime.

Neni 22
Shlyerja e dënimit në rastin e ndarjes së personit juridik

1. Në rastin e ndarjes, personat juridikë që krijohen detyrohen solidarisht për shlyerjen e dënimit me gjobë, të dhënë ndaj personit juridik të ndarë, për vepra penale të kryera përpara datës së ndarjes. Detyrimi i personave juridikë caktohet në varësi të raportit të vlerës efektive të pasurisë neto, që u është transferuar nga personi juridik i ndarë, të kalimit të veprimtarive apo strukturave, që janë përdorur e që për shkak të të cilave është kryer vepra penale.

2. Dënimi për mbarimin e personit juridik dhe dënimet plotësuese zbatohen ndaj personit ose personave juridikë, që kanë trashëguar veprimtarinë ose strukturën e personit juridik të ndarë, që është përdorur apo për shkak të të cilave është kryer vepra penale.

Neni 23
Caktimi i dënimit me gjobë në rastin e bashkimit ose të ndarjes

Nëse bashkimi ose ndarja ndodhin përpara përfundimit të gjykimit, gjykata, në caktimin e dënimit me gjobë, mban parasysh kushtet ekonomike e pasurore të personit juridik, i cili është fillimisht përgjegjës.

Neni 24
Rehabilitimi

Personi juridik quhet i padënuar nëse nuk ka kryer një vepër tjetër penale brenda afateve të mëposhtme:

a) gjatë pesë vjetëve nga data e shlyerjes së plotë të gjobës, në rastin e dënimit me gjobë;

b) gjatë tre vjetëve nga data e ekzekutimit të tyre, në rastin e dënimeve të tjera.

KREU V
DISPOZITA PROCEDURALE

Neni 25
Personi juridik në procedimin penal

Ndaj personit juridik, që ka përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, për aq sa është e mundur, zbatohen dispozitat procedurale penale për personin në hetim dhe të pandehurin.

Neni 26
Përfaqësimi i personit juridik

1. Personi juridik, që procedohet penalisht, përfaqësohet nga organi i personit juridik ose avokati i emëruar prej tij.

2. Përfaqësuesi në procedimin penal caktohet brenda 10 ditëve nga njoftimi i prokurorit, nga organet e personit juridik që, sipas ligjit dhe akteve të shoqërisë, kanë të drejtën e vendimmarrjes dhe të përfaqësimit të tij tek të tretët.

3. Përfaqësues i personit juridik nuk mund të jetë personi, që thirret në cilësinë e dëshmitarit ose procedohet penalisht për të njëjtën vepër penale.

4. Nëse personi juridik nuk cakton përfaqësuesin e vet brenda afatit të caktuar në pikën 2 të këtij neni, ai caktohet nga organi procedues ose gjykata.

Neni 27
Bashkimi i procedimeve

Për veprën penale të kryer nga personi juridik dhe organet apo përfaqësuesit e tij zbatohen rregullat procedurale të bashkimit të procedimeve të lidhura.

Neni 28
Veprime procedurale në fazën e gjykimit të çështjes

1. Në rastin e bashkimit të procedimeve, në fazën e gjykimit të çështjes, i pari që ka të drejtën e paraqitjes së kërkimeve është organi ose përfaqësuesi i personit juridik që ndiqet penalisht.

2. Paraqitja e provave në procedimin penal caktohet duke u mbështetur në kërkimet e organit të personit juridik ose përfaqësuesit të tij që ndiqet penalisht, pavarësisht nga ato të përfaqësuesit të personit juridik. Personi i parë që pyetet nga gjykata është organi i personit juridik ose përfaqësuesi i tij që ndiqet penalisht për të njëjtën vepër penale.

3. Në diskutimin përfundimtar, të drejtën e fjalës së fundit e ka organi i personit juridik ose përfaqësuesi i tij që ndiqet penalisht për të njëjtën vepër penale.

Neni 29
Elementet e vendimit

Në vendimin e dënimit të personit juridik, përveç elementeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, duhet të përcaktohen edhe:

a) selia qendrore;

b) forma e shoqërisë dhe emërtimi;

c) numri i vendimit të regjistrimit si person juridik;

ç) gjenealitetet e përfaqësuesit të tij.

Neni 30
Gjendja gjyqësore e personave juridikë

1. Dispozitat e titullit IX kreu III të Kodit të Procedurës Penale zbatohen edhe për personat juridikë të dënuar penalisht, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Kopjet e vendimeve të dhëna ndaj personave juridikë për kryerjen e veprave penale dërgohen pranë regjistrit përkatës të personave juridikë, ku ata janë të regjistruar, duke bërë edhe shënimet përkatëse, sipas ligjit.

Neni 31
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 2007.

Shpallur me dekretin nr.5372, datë 25.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9755, datë 14.6.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7512, DATË 10.8.1991 "PËR SANKSIONIMIN DHE MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE, TË NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE TË PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Neni 5 shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 2007.

Shpallur me dekretin nr.5373, datë 25.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare
ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark",
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	**PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)…….....**	**1500**
2.	**PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) …….....**	**600**
3.	**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....**	**1300**
4.	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT…….....**	**500**

Botime të reja

1	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…....….....**	**1000**
2	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…....….....**	**500**
3	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…….….....**	**1000**
4	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…….….....**	**500**
5	**PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË…….....**	**1000**
6	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR……**	**800**
7	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET…….....….....**	**500**
8	**PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)……**	**1000**
9	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE…….....**	**500**

Hyri në shtyp më 26.6.2007
Doli nga shtypi më 28.6.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë